20/01/2021

Më 20 janar Kisha Ortodokse Bullgare respekton Patrikun Shenjtor Evtimij Tërnovoski



Më 20 janar Kisha Ortodokse Bullgare nderon Patrikun Bullgar Evtimij Tërnovski. I lindur në vitin 1327 Evtimij e kishte prejardhjen nga një fisi i njohur fisnik. Ai mori arsim të mirë laik, por kërkimet e tij shpirtërore e çuan në Manastirin Kilifarevski, ku rreth vitit 1350 u shugurua murg. Pas kësaj në vazhdim të 7 viteve ai jetonte në Stamboll dhe në Malin e Shenjtë.

Duke u kthyer në atdhe, Evtimij u vetmua në një shpellë jo larg qytetit Tërnovo ku themeloi Manastirin “Shën Trinia e Shenjtë”. Në vitin 1371 ai hodhi themelet e Shkollës Letrare të Tërnovos, e cila luajti rol të rëndësishëm në zhvillimin e letërsisë bullgare. Ai realizoi dhe një reformë të rëndësishme drejtshkrimore e cila kishte për qëllim të vendosë unitet në drejtshkrimin dhe gjuhën letrare.

Në vitin 1375 u zgjodh Patrik i Bullgarisë.

— bnr.bg